



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e datës 18.06.2008
Salla nr. N.225 ora 14,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Drita Kadriu, Memli Krasniqi, Vlora Çitaku, Adem Hajdaraj, Fatmire Berisha, Donika Kadaj-Bujupi dhe Mark Krasniqi.
Munguan: Agim Veliu, Enis Kervan, Hestet Cakolli dhe Dragan Dimiq

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Bajram Badivuku, Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Drita Kadriu zëvendës kryesuese e parë e Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kualifikimet Kombëtare
4. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.

Drita Kadriu zv. kryesuese e parë e Komisionit, njihërit si referuese e Projektligjit i njoftoi anëtarët e tjerë të Komisionit lidhur me punën e saj në amendamentimin e Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.

Ajo shtoi se struktura e brendshme e Projektligjit është e paqartë dhe se duhet bërë shumë ndërhyrje në amendamentimin e të njëjtit me qëllim që të kemi një ligj të duhur.

Me këtë rast ajo shtoi se Ligji për Teatrin shërben si një model i mirë në strukturimin dhe amendamentimin e këtij projektligji.

Vlora Çitaku në diskutimin e saj tha se duhet bërë qartësimin dhe strukturimin e Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera duke u bazuar nga Ligji për Teatrin.

Memli Krasniqi gjithashtu ishte i mendimit se Ligji i Teatrit do të shërbejë si bazë e mirë për amendamentimin e mëtejshëm të Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.

Donika Kadaj tha se duhet të bëjmë tryzni në Ministrinë e Kulturës, dhe si Komision të kërkojmë që Ministria e Kulturës Rinisë e Sportit të harton Projektligje më cilësore.

Adem Hajdaraj tha se bashkarisht si Komision duhet të shqyrtojmë nen për nen Projektligjin dhe të amendamentohet në mënyrë që të kemi një ligj funksional.

Pas debatimit Komisioni vendosi që të shqyrtojë nen për nen Projektligjin për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera duke u bazuar nga Ligji për Teatrin.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kualifikimet Kombëtare

Lidhur me këtë pikë anëtarja e Komisionit Vlora Çitaku konstatoi se do angazhohet si referuese në amendamentimin e Projektligjit për Kualifikimet Kombëtare.

4. Të ndryshme

Vlora Çitaku diskutoi lidhur me procesin e mbajtjes së testit të maturës sipas Ligjit për Provimin Përfundimtar dhe të Maturës. Ajo shprehi shqetësimin e saj lidhur me rezultatet e testit të maturës shtetërore dhe lidhur me këtë kërkoi që të organizohet ndonjë debat edhe me Ministrinë në mënyrë që të ketë sukses më të lartë në këtë aspekt.

Memli Krasniqi lidhur me këtë rast tha se rezultatet e testit të maturës shtetërore të këtij viti janë më të larta në krahasim me testin e organizuar në vitin e kaluar.

Donika Kadaj tha se si Komision do duhej të dalim me një qëndrim lidhur me rezultatet e testit të maturës shtetërore, të organizohet një dëgjim së bashku me Ministrinë në mënyrë që të sensibilizohet gjendja në arsim.

Adem Hajdaraj lidhur me këtë tha se testi i maturës shtetërore ka qenë mirë i organizuar dhe se rezultatet e provimit nuk janë shqetësuese ngase është edhe afat i muajit gusht.

Fatmire Berisha në diskutimin e saj tha se për tu kuptuar mirë situata në këtë aspekt duhet nisur dhe analizuar nga shumë çështje siq janë kurrikulet, vlerësimi notimi etj.

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të mbahet të hënën e ardhshme më datë 23.06.08 në orën 13,00 me shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.

Mbledhja përfundoi në orën 15,20

Zv e parë e Komisionit,
Drita Kadriu